



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 6, datë 30.09.2021

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR RINOVIMIN E
KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”,
SHOQËRISË “BARDHGJANA” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike, subjektit “Bardhgjana” sh.p.k., me vendndodhje Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

- X=510464.74
 - Y=4639557.66
 - Z=703 m.m.n.d
- Qllog = 0.3 m³/sek

3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të permbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT
GJOKË JAKU

